

Udhëzimi nr. 44, datë 21.08.2013 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 30, datë 29.12.2017

Baza ligjore	Përshkruesit praktikë	Po/Jo	Komente
Kreu 1	Të gjithë shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, të ardhur nga jashtë vendit (që do të ndjekin arsimin në Republikën e Shqipërisë), u është dhënë e drejta për të siguruar njëvlershmërinë e dëftesave dhe diplomave të arsimit parauniversitar, të fituara jashtë Republikës së Shqipërisë.		
Kreu 2, Gërma I, Pika 1	Njësia arsimore vendore ka kryer procedurat e njëvlershmërisë së dëftesave të arsimit të detyruar të nxënësve të ardhur nga jashtë vendit.		
Kreu 2, Gërma I Pika 2	Njësia arsimore vendore ka kryer procedurat e njëvlershmërisë në çdo kohë.		
Kreu 2, Gërma I Pika 3, Gërma a (e # me 30/1/a/a)	Nxënësi, për njëvlershmërinë e dëftesës së arsimit të detyruar, ka paraqitur pranë njësisë arsimore vendore, kërkesën për njëvlershmërinë dhe deklaratën me shkrim të prindit.		
Kreu 2, Gërma I Pika 3, Gërma b (e # me 30/1/a/b)	Nxënësi, për njëvlershmërinë e dëftesës së arsimit të detyruar, ka paraqitur pranë njësisë arsimore vendore dokumentet e vijueshmërisë së klasës, të përkthyer dhe të noterizuara, të pajisura me vulë apostile të shtetit nga vijnë.		
Kreu 2, Gërma I Pika 4	Njësia arsimore vendore ka njoftuar zyrtarisht drejtorinë e shkollës për klasën ku nxënësi do të regjistrohet dhe për vlerësimet e konvertuara.		
Kreu 2, Gërma I Pika 5	Njësia arsimore vendore, në mungesë të dokumentacionit të pikës 3/b, ka njoftuar drejtorin e shkollës që të ngrejë një komision për vlerësimin e nxënësit, për klasën e pretenduar nga deklarimi me shkrim i prindit. Nxënësi është regjistruar në klasën që ka miratuar komisioni.		
Kreu 2, Gërma I Pika 6	Drejtoria e shkollës, pas regjistrimit të nxënësit, ka organizuar hartimin dhe zbatimin nga mësuesit të programeve individuale, që synojnë plotësimin e mangësive të nxënësit.		
Kreu 2, Gërma II Pika 1	Njësia arsimore vendore ka kryer procedurat e njëvlershmërisë së dëftesave të arsimit të mesëm të lartë të nxënësve të ardhur nga jashtë vendit.		
Kreu 2, Gërma II, Pika 2	Njësia arsimore vendore ka kryer procedurat e njëvlershmërisë së dëftesave të arsimit të mesëm të lartë të nxënësve të ardhur nga jashtë vendit në çdo kohë.		
Kreu 2, Gërma II, Pika 3, Gërma a (e # me 30/1/b/a)	Nxënësi, për njëvlershmërinë e dëftesës në arsimin e mesëm të lartë, ka paraqitur pranë njësisë arsimore vendore kërkesën për njëvlershmërinë dhe deklaratën me shkrim të prindit.		
Kreu 2, Gërma II, Pika 3, Gërma b (e # me 30/1/b/b)	Nxënësi, për njëvlershmërinë e dëftesës në arsimin e mesëm të lartë, ka paraqitur pranë njësisë arsimore vendore dokumentet e vijueshmërisë së klasës, të përkthyer dhe të noterizuara, të pajisura me vulë apostile të shtetit nga vijnë.		
Kreu 2, Gërma II, Pika 4	Njësia arsimore vendore, mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar dhe planit mësimor të shkollës, ku nxënësi do të regjistrohet, ka dërguar zyrtarisht në shkollë vërtetimin e njëvlershmërisë për lëndët që nxënësi ka kryer, sipas planit mësimor të shkollës pritëse, si dhe lëndët të cilat duhet të japë provim.		
Kreu 2, Gërma II, Pika 4, Gërma a	Nxënësi (në AML) ka përsëritur klasën kur ka plotësuar më pak se gjysmën e krediteve të kurrikulës bërthamë dhe asaj me zgjedhje të detyruar të klasës ku kërkon të regjistrohet.		

Kreu 2, Gërma II, Pika 4, Gërma b	Nxënësi (në AML) është regjistruar në klasën që ka kërkuar dhe ka dhënë provim çdo lëndë që nuk ka kryer dhe që i përket planit mësimor, kur ka plotësuar më shumë se gjysmën e krediteve të kurrikulës bërthamë dhe asaj me zgjedhje të detyruar të klasës ku ka kërkuar të regjistrohet. Provimet janë dhënë në periudhën 15 shtator deri 15 nëntor, ose 15 janar deri me 15 mars.		
Kreu 2, Gërma II, Pika 5, Gërma a	Drejtori i shkollës (AML) ka caktuar datat e provimeve lëndore në periudhën e përcaktuar në pikën 4/b, të këtij udhëzimi.		
Kreu 2, Gërma II, Pika 5, Gërma b	Drejtori i shkollës (AML) ka ngritur komisionet lëndore, që përbëhen, për çdo lëndë, nga të paktën dy mësues, të cilët kanë hartuar testin, kanë administruar provimin dhe kanë vlerësuar përgjigjet e nxënësve.		